



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВА - GOVERNMENT OF KOSOVO			
QEVERIA E KOSOVËS - Vlada e Kosovës - OFFICE OF THE PRIME MINISTER			
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org. Org. Unit	02.1.0	Nr. Prot. Prot. No.	546/2
Nr. ffaqeve Br. stranica No. pages	- 2 -	Data: Datum: Date:	13 05 / 2026
Prishtinë/а			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Datë: 13.05.2026**

Mbledhja e nëntëmbëdhjetë (19) e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbahet më 14.05.2026, në orën 15:00, ndërtesa e Qeverisë, salla P-31.

**RENDI I DITËS**

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore për nevoja të Ofruesit për Shërbimet e Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës (ish-ASHNA) (MMPH)
2. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Financave për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 04/04, të datës 13 mars 2026 (MF)
3. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 22/39, të datës 13 tetor 2021, për themelimin e Komisionit Ministror për Skemën Evropiane të Garancisë për të Rinjtë (MPFVLÇ)
4. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare për themelimin e Komisionit Ministror për Skemën Evropiane të Garancisë për Fëmijët (MPFVLÇ)
5. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, për themelimin e Këshillit Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (MPFVLÇ)
6. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, për Miratimin e Zgjatjes së Planit të Implementimit të Skemës për Garancinë për të Rinjtë - 2026 (MPFVLÇ)
7. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/214, të datës 24 korrik 2024, për themelimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar Gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës (MPFVLÇ)
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përditësimin e Listës Shtetërore Strategjike për Mallra Ushtarake, duke iu referuar Listës së Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike, ose për arsye të të drejtave të njeriut (MINTI)

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Qarkores së Vjetër të qytetit të Gjilanit" (MMPH)
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Rehabilitimi, zgjerimi dhe asfaltimi i Rrugës Nacionale R118, segmenti brenda fshatit Mushtisht" (MMPH)
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Zgjerimi i mihjes sipërfaqësore për eksploatim të thëngjillit, për prodhim të energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energetike të Kosovës" (KEK-Sh. A.) (MMPH)
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtim të mëtejme të Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, të cilat janë të nevojshme për realizimin e disa projekteve të Komunës së Podujevës (MMPH)
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtim të mëtejme të Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, për realizimin e projekteve "Ndërtimi i Tregut të Kafshëve" dhe "Ndërtimi i Tregut të Gjelbër", të Komunës së Podujevës (MMPH)
14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtim të mëtejme të Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, për realizimin e projekteve "Ndërtimi i banesave me kosto të përbalueshme" dhe "Objektet Edukativo-Arsimore - Çerdhe për fëmijë" (MMPH)
15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve në Ministrinë e Kulturës dhe të Turizmit, me kod 207, për zbatimin e programit "Masat preventive - intervenime emergjente nëpër komuna të ndryshme" (MKT)
16. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rialokim të mjeteve buxhetore deri në 25% të ndarjes së ndikuar negativisht, të vlerës totale të kategorisë së shpenzimeve "Investime Kapitale" të aprovuar për nënprogramin "Administrata Qendrore" (MF)
17. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/220, të datës 11 shtator 2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 09/280, të datës 12 dhjetor 2025 (ZKM)
18. Informimi për Raportin e Vlerësimit të Ligjshmërisë të Akteve të Kuvendeve të Komunave për vitin 2025 (MAPL)
19. Të ndryshme